



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:004759

Datë: 13.02.2024

Numri i dokumentit: 05321623

P.nr.4/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit F.L nga Ferizaj, i akuzuar për veprën penale në vazhdim, Vjedhje e sherbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 par.1 te KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP/II.nr.5/21 të datës 11.01.2021, PP/II.nr.132/23 të datës 23.02.2023 dhe PP/II.nr.483/21 të datës 26.04.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt.07.02.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Avdulla Abedini, përfaqësuesit të dëmtuarës, Arban Mehmeti me autorizim dhe të pandehurit, me dt.12.02.2024 mori dhe shpalli , ndërsa me dt.13.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri F.L nga Ferizaj, rr. “...”objekti banesor te Kinemaja, hy.1 kati i tetë, i lindur më dt. ... nga i ati K... dhe e ema A... , e gjinisë E..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves , i martuar, prind i 4 femijeve , ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal:

ËSHTË FAJTOR

I. Me 13.08.2019, në fshatin ..., Komuna Kaçanik, saktësisht në shtëpinë e tij, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm ka siguruar shërbime për të cilat e ka ditur se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompenzimit në atë mënyrë që gjatë një kontrolli të njësorit elektrik me numër ... nga zyrtarët e KEDS-it, kanë konstatuar se ka qenë i çkyqur nga distanca për shkak të borgjit dhe ditën kritike është hasur në lidhje direkte në rrjetin elektrik ashtu që energji elektrike e shfrytëzuar nuk është regjistruar, me këtë ka dëmtuar KEDS-in në shumë prej 43.56€,

II. Prej datës së pavërtetuar e deri 07.11.2019, i pandehuri, në shtëpinë e tij fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 24.47 Euro,-

III. Prej datës së pavërtetuar e deri 14.12.2019, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 25.16 Euro,-

IV. Prej datës së pavërtetuar e deri 30.01.2020, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 32.64 Euro,-

V. Prej datës së pavërtetuar e deri 11.03.2020, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të

KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 27.86 Euro,-

VI. Prej datës së pavërtetuar e deri 26.03.2020, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, me një kabull 3x2.5, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 31.60 Euro,-

VII. Prej datës së pavërtetuar e deri 08.04.2020, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 8.85 Euro,-

VIII. Prej datës së pavërtetuar e deri 06.05.2020, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 58.95 Euro,-

IX. Prej datës së pavërtetuar e deri 10.06.2020, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 23.78 Euro,-

X. Prej datës së pavërtetuar e deri 09.07.2020, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen

vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 19.71 Euro,-

XI. Prej datës së pavërtetuar e deri 13.08.2020, i pandehuri në shtëpinë e tij, fshati ..., Kaçanik, më qëllim të sigurimit të shërbimeve me energji elektrike për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, gjatë kontrollit nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është hasur duke keqpërdor energjinë elektrike, ashtu që është kyçur direkt jashtë pikës matëse, me një kabull 2x2.5, energjia e shpenzuar nuk është (matur) regjistruar, me ç' rast dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 73.72 Euro.-

XII. Prej datës së pavërtetuar deri me datë 10.11.2020, në shtëpinë e tij, në fshatin ... K.Kaçanik, gjatë një kontrolli nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS-it, Distrikti Ferizaj është hasur duke keqpërdorur energjinë elektrike, në atë mënyrë është kyçur direkt në rrjetin elektrik, duke anashkaluar njëisorin elektrik me nr.32593769, i cili ka qenë i ç kyçur nga distanca për shkak të mos pagesës së borxhit, me ç' rast energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare, me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in në shumë prej 139.00 €,-

XIII. Me 22.09.2022, në fshatin ..., Komuna Kaçanik, saktësisht në shtëpinë e tij, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm ka siguruar shërbime për të cilat e ka ditur se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompenzimit në atë mënyrë që gjatë një kontrolli të njëisorit elektrik me numër 32593769 nga zyrtarët e KEDS-it, kanë konstatuar se ka qenë i çkyçur nga distanca për shkak të borgjit dhe ditën kritike është hasur në lidhje direkte në rrjetin elektrik ashtu që energji elektrike e shfrytëzuar nuk është regjistruar, me këtë ka dëmtuar KEDS-in në shumë prej 471.55€,

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve ne vazhdim nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-se , të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 1000.00€ (njëmijë euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë në afatin prej tre muajve pas plotfuqishmërise së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zevendesojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 50.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara, KEDS Distrikti Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat: PP/II.nr.5/21 të dates 11.01.2021, PP/II.nr.483/21 të datës 26.04.2021 dhe PP/II.nr.132/23 të datës 23.02.2023, të pandehurin F.L nga Ferizaj, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të aktakuzës, PP/II.nr.5/21 të datës 11.01.2021, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.13.01.2022, me të cilin rast palët janë pajtuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetesimit, mirëpo meqë palët nuk kanë arritur marrëveshje në procedurë të ndërmjetesimit, gjykata ka vazhduar me shqyrtimin e rregullt të lëndës.

Në seancën e vazhduar të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.16.05.2023, pasi që gjykata ka konstatuar se sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroria Themelore Ferizaj: PP/II.nr.5/21 të

datës 11.01.2021, PP/II.nr.483/21 të datës 26.04.2021 dhe PP/II.nr.132/23 të datës 23.02.2023, janë formuar lëndët penale, P.nr.5/21, P.nr.117/21 dhe 2023:051955, pas dëgjimit të palëve, me aktvendim ka bashkuar lëndët e evidentuara pranë kësaj gjykate në një lëndë të posaçme dhe ka udhëhequr procedurën sipas lëndës P.nr.5/21.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij në shqyrtimin fillestar, me rastin e prezantimit të aktakuzave, pasi qe konstatoi se plotësohen më shumë se dy kushte nga 77 i KPRK-së, ka bërë rikualifikimin juridik të veprave penale, ashtu qe nga tri vepra penale veq e veq, bashkohen në një vepër penale në vazhdim dhe kualifikohet si vepra penale, Vjedhje e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Meqenëse I pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale, Vjedhje e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me të cilin rast prokurori I shtetit Avdulla Abedini, deklaroi se mbetet në tërësi pranë akatkuazës së rikualifikuar në senacën e shqyrtimit fillestar, pa ndryshime dhe plotësime. Në fjalën e tij perfundimtare deklaroi se, pas ndëgjimit të dëshmitarëve – zyrtarëve të KEDS- it, gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilët në mënyrë bindëse dëshmuan se kanë qenë kryer kontrollë të njësorit elektrik tek i pandehuri ne fsh. ... në Kacanik, me dt. e cekura si në dispozitiv të aktakuzave dhe te njëjtit kane hasur në kyqje direkte përmes një kablli nga rrjeti elektrik në shtëpinë e të pandehurit, duke anashkaluar njehsorin elektrik, me qëllim që energjia e hargjuar mos të matet apo mos të regjistrohet, po ashtu nga dëshmitarët është vërtetuar se ka në disa raste të kontrolleve, kanë qenë prezent edhe anëtarë të familjes së të pandehurit, si bashkshortja, djali, e me lejen e te cilëve, punëtorët e KEDS-it, kanë hyrë mbrenda në shtëpinë e të pandehurit dhe kane vërtetur se pajisjet elektrike shtëpiake kane qenë në funksion respektivisht kanë qenë duke u furnizuar me energji elektrike . Po nga këto dëshmitarë, u vërtetua se, ne secilin rast që kanë qenë në kontrollë, kanë bërë fotografi të vendit ku shihet lidhja direkte, në disa prej të cilave, përveq datës dhe kohës kur janë bërë fotografitë figuron edhe emri I rrugës ku gjindet shtëpia e të pandehurit, te cilin fakt nuk e konteston as i pandehuri, e poashtu në njërën prej fotografive është vërejtur edhe një dritë e nderur në shtëpi. Andaj mbrojtja e te pandehurit se nuk ka qëndruar në shtëpinë e tij në fsh....., pas vitit vitit 2019 nuk është relevante, për faktin se njëtori elektrik në shtëpinë në fsh.... ka qenë në emër të tij, shtëpinë e ka shfrytëzuar vetëm I pandehuri me familje dhe jo edhe dikush tjetër, dhe duke patur parasysh edhe dëshminë e dëshmitarve dhe provat materiale konsideron se në veprimet e të pandehurit janë manifestohet të gjitha elementet e veprës penale, Vjedhja e

shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Andaj I propozon gjykatës që të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'i shqiptojë një sanksion penal të paraparë me ligj, me te cilin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së .

Përfaqësuesi I të dëmtuarës në fjalën e tij, në shqyrtimin gjyqësor, e ka mbështetur fjalën e prokurorit e shtetit dhe ka deklaruar se I bashkangjitet ndjekjes penale dhe ka parashtruar kërkesë pasurore juridike në vlerë prej 937.59 €.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha dispozitivet e për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se e pranon fajësinë vetëm për rastet që kanë të bëjnë në vitin 2019, sepse në fillim të vitit 2020 është shpërngul në Ferizaj, ku edhe vazhdon të jetojë atje. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se, ka patur raste kur ka shku në fsh.... për të marrë dru, por që nuk ka shfrytëzuar energjinë elektrike në shtëpinë e tij, por vetëm e ka marrë traktorin dhe ka shku në mal për dru. I njejt më tutje ka theksuar se e ka vërejtur një kabëll të rrymës, të cilën punëtorët e KEDS-it e kishin hjek në vitin 2019 dhe të njejtën e kishin lidhur për shtyllën në të cilën është I vendosur njehsori elektrik, I cili është I vendosur shumë lart në shtyllë dhe nuk ka mundësi që të bëhet lidhja e rrymës. I pandehuri deklaron se ndermjetësimi, për një pjesë të rasteve për të cilat e ngarkon aktakuza, kishte dështuar për shkak se nuk kishte mundësi me pagu dëmin e vlerësuar nga ana e KEDS-it, dhe shton se para rreth një viti ka bërë një kërkesë me shkrim në Ferizaj që të bëhet lidhja zyrtare në rrjetin elektrik ose të shkyqet nga rrjeti elektrik. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se lidhur me lidhjet ilegale në rrjetin elektrik, që kane ndodhur në shtëpinë e tij në fsh. ..., pas vitit 2019, nuk e ndien veten fajtor, por megjithatë kërkon nga gjykata që nëse veq gjindet fajtor për këto raste, t'i shqiptohet nje dënim sa me i ulet që të jete e mundur, meqë nuk jeton në kushte të mira ekonomike. Nuk ka prezentuar para gjykatës ndonjë prove për vërtetimin e gjendjes së dobët ekonomike.

Gjykata ne shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me dëgjimin e dëshmitarëve: S. Q., B. R., Sh. M., M. C., V. F., dhe A. T., leximin e procesverbaleve mbi konstatimin e gjendjes faktike në teren me numra dhe dt.si në vijim: ... të dt.13.08.2019, ... të dt.07.11.2019, ...të dt.14.12.2019, ... të dt.30.01.2020, ... të dt.11.02.2020, ... të dt.26.03.2020, ... të dt.08.04.2020, ... të dt.06.05.2020,... të dt.10.06.2020, ... të dt.09.07.2020, ... të dt.13.08.2020, .. të dt.10.11.2020 dhe procesverali me nr.... të dt.22.09.2022, bashkë me raportet e kalkulimit të rikthimit të humbjeve dhe me fotografitë për secilin rast konkret.

Nga deklarata e dëshmitarit S. Q., gjykata vërtetoi se I njejti, gjatë vitit 2020, ka qenë në punë në KEDS Distrikti Ferizaj, në kontrollimin e humbjeve, dhe se me dt.30.01.2020, 26.03.2020, 13.08.2020 dhe 10.11.2020, ka qenë pjesë e ekipit të kontrollit në shtëpinë e të pandehurit në fsh....-Kaçanik, dhe në secilin prej kontrolleve, është hasur në lidhje direkte jashtë pikës matëse, përmes një kablli nga shtëpia e të pandehurit deri te rrjeti kryesor elektrik, e cila lidhje është eliminuar, por kabli nuk është marrë nga dëshmitari me kolegët e tij, dhe lidhur me këto raste, pasi që janë bërë fotografitë e vendit të ngjarjes, në rast se ka qenë e mundur janë regjistruar pajisjet dhe është përpiluar procesverbal, një kopje e të cilit është lënë për konsumatorin-të pandehurin në këtë rast.

Nga deklarata e dëshmitarit B. R., gjykata vërtetoi se I njejti, gjatë vitit 2019-2020, ka qenë në punë në KEDS Distrikti Ferizaj, në kontrollimin e humbjeve, dhe se me dt.08.04.2020, 10.06.2020 dhe 13.08.2020, ka qenë pjesë e ekipit të kontrollit në shtëpinë e të pandehurit në fsh....-Kaçanik, dhe në secilin prej kontrolleve, është hasur në lidhje direkte jashtë pikës matëse, dhe për pasojë energjia elektrike e shfrytëzuar nuk është regjistruar në njehsorin elektrik. Po nga ky dëshmitar gjykata ka vërtetuar se lidhja e paautorizuar në rrjetin elektrik është bërë përmes një kablli nga shtëpia e të pandehurit deri te rrjeti kryesor elektrik, e cila lidhje është eliminuar, dhe lidhur me këto raste, pasi që janë bërë fotografitë e vendit të ngjarjes, në rast se ka qenë dikush në shtëpi janë regjistruar pajisjet dhe është përpiluar procesverbal, një kopje e të cilit është lënë për konsumatorin.

Nga deklarata e dëshmitarit Sh. M., gjykata vërtetoi se I njejti, si punëtor I KEDS-it, ka qenë pjesë e ekipit të kontrollit të njehsorit elektrik, në shtëpinë e të pandehurit në fsh....-Kaçanik, me dt.10.11.2020 me të cilën deklaratë konfirmohet edhe deklarata e dëshmitarit S. Q., lidhur me lidhjen direkte përmes një kablli 3X2.5 mm, nga shtëpia e të pandehurit deri në rrjetin kryesor elektrik, pasi që njehsori elektrik I të pandehurit si konsumator, më parë ka qenë I shkyqur nga distanca.

Nga deklaratat e dëshmitarëve: M. C. dhe V.F., gjykata vërtetoi se me dt.22.09.2022 të njejtit kanë qenë në kontroll inspektues të njehsorit elektrik tek shtëpia e të pandehurit në fsh...., me të cilin rast kanë konstatuar se njehsori elektrik tip Smart ka qenë I vendosur në shtyllën elektrike dhe I shkyqur për shkak të borgjit të konsumatorit ndaj KEDS-it, por I pandehuri është kyqur direct në rrjetin elektrik duke anashkaluar njehsorin elektrik. Nga këto dëshmitarë gjykata

poashtu ka vërtetuar se ditën kritike, me rastin e realizimit të fotografive, ndër të tjera është fokusuar edhe një pjesë e shtëpisë ku vërehet poqi elektrik I dhezur, që nënkupton faktin se pavarësisht që njehsori ka qenë I shkyqur, I pandehuri ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, dhe atë përmes një kablli të lidhur nga shtëpia e tij deri te rrjeti kryesor elektrik.

Nga deklarata e dëshmitarit A. T., gjykata poashtu ka vërtetuar faktin se me dt.30.01.2020 dhe me dt.26.03.2020 I njejtë ka qenë në kontrollë inspektuese të njehsorit elektrik tek shtëpia e të pandehurit në fsh....-Kaçanik, me të cilin rast është konstatuar lidhja direkte në rrjetin elektrik, jashtë pikes matëse, përmes një kablli 3x2.5 mm, për çka edhe në këtë rast, si edhe në rastet tjera janë bërë fotografi dhe është përpiluar procesverbal, një kopje e të cilit është lënë për konsumatorin, në këtë rast I pandehur.

Fakte të njejta si me deklarata e dëshmitarëve, janë vërtetuar edhe nga provat materiale si: procesverbali me nr. 2504695 i dt.13.08.2019, procesverbali me nr.2490986 i dt.07.11.2019, procesverbali me nr.2499271 i dt.14.12.2019, procesverbali me nr.2485729 I dt.30.01.2020, procesverbali me nr.2481868 i dt.11.02.2020, procesverbali me nr.2490628 i dt.26.03.2020, procesverbali me nr.2258444 i dt.08.04.2020, procesverbali me nr.2411755 i dt.06.05.2020, procesverbali me nr.2512497 i dt.10.06.2020, procesverbali me nr. 2309389 i dt.09.07.2020, procesverbali me nr.0900639 i dt.13.08.2020, procesverbali me nr.2510672 i dt.10.11.2020 dhe procesverbali me nr.20200390 I dt.22.09.2022, bashkë me raportet e kalkulimit të rikthimit të humbjeve me fotografitë për secilin procesverbal.

Pas prezantimit të provave dhe vlerësimit të tyre te plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes se të pandehurit si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si ne dispozitiv.

Gjykata u dha besimin provave të prezantuara sepse me të njëjtat ne mënyrë të qartë dhe bindëse është përshkruar koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, dhe se këto prova, pjesërisht gjejnë mbështetje edhe në vetë mbrojtjen e të pandehurit.

Gjykata vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit, ku i njëjti thot se vitin që nga fillimi I vitit 2020 nuk jeton në fsh....-Kaçanik, pasi që është shpërngul në Ferizaj, ku edhe vazhdon të jetojë atje, edhe pse pranon faktin se , ka patur raste kur ka shku në fsh.... për të

marrë dru, por që nuk ka shfrytëzuar energjinë elektrike në shtëpinë e tij, por vetëm e ka marrë traktorin dhe ka shku në mal për dru. I njejt, në mbrojtjen e tij poashtu ka pranuar se tek shtëpia e tij në fsh....., e ka vërejtur një kabëll të rrymës, të cilën punëtorët e KEDS-it e kishin hjek në vitin 2019 dhe të njejtën e kishin lidhur për shtyllën në të cilën është I vendosur njehsori elektrik, I cili është I vendosur shumë lart në shtyllë dhe nuk ka mundësi që të bëhet lidhja e rrymës. I njejt në mbrojtjen e tij ka pranuar se gjatë vitit 2019 ka patur lidhje ilegale në rrjetin elektrik, por jo edhe në vitin 2020.

Një mbrojtje të tillë gjykata nuk i fali besimin meqë, bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve , secilit veq e veq, dhe provave materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, e pjesërisht edhe nga vetë deklarimi i të pandehurit, konstatohet se ky I fundit në të gjitha datat e cekura si në dispozitiv ka qenë I kyqur direct në rrjetin elektrik, përmes një kablli nga shtëpia e tij deri te rrjeti kryesor elektrik, pasi që I njejt si konsumator e ka patur të shkyqur njehsorin elektrik tip Smart nga distanca, ndërsa I pandehuri ka shfrytëzuar energji elektrike jashtë pikes matëse.

Nisur nga të gjitha këto këto fakte te vërtetuara ne procedurë, gjykata vërtetoi se ne veprimet e te pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale në vazhdim, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPK-së, kështu që në rastin konkret rrethana lehtësuese nuk u gjetën, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh faktin se, bazuar në evidencën penale i njëjt ka patur të regjistruara edhe raste të tjera të ngjashme penale, të cilat I ka zgjidhur përmes procedures së ndërmjetësimit, dhe shkallën e lartë të dashjes së të pandehurit për të kryer veprën penale, duke patur parasysh faktin se të njejt pavarësisht faktit që disa herë I është shkyqur nga distanca njehsori elektrik, I njejt prapë është kyqur në rrjetin kryesor elektrik, në mënyrë të paautorizuar, përmes një kablli 3x2.5 mm, duke anashkaluar njehsorin elektrik.

Andaj, gjykata për këto arsye, të pandehurin F.L , i akuzuar për veprën penal në vazhdim, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe

konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhezimin e të dëmtuarit në contest civil u mor konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr. 4/21 datë 13.02.2024

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.